

*Në Durrës më 16. 04.2026*

## **KALLËZIM PENAL**

**KALLZUES:** Erion Veliaj, i biri i Luan, lindur më 17.12.1979, banues në Tiranë, aktualisht në paraburgimin e IEVP, Durrës, identifikuar me numër personal H91217035J.

**ME OBJEKT:** Kallzim i veprës penale “Falsifikimi i dokumentave”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal si dhe çdo vepër tjetër penale që rezulton gjatë hetimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 280, 283 të K.Pr.Penale dhe neni 186 i Kodit Penal.

**DREJTUAR:** Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

### **I nderuar Z. Prokuror,**

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në bazë të dokumentit “Të dhëna për SPAK”, ka filluar verifikimet dhe më pas ka regjistruar kundër personit tim, në datën 08.02.2024, procedimin penal nr. 27. Si bazë për fillimin e procedimit penal ndaj meje ka shërbyer dokumenti “Të dhëna për SPAK”, i hartuar dhe i nënshkruar nga një person i vetëidentifikuar si “Nesti Angoni”. Nga verifikimet e kryera nga vetë Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar rezulton se ky person nuk ekziston në regjistrin kombëtar të gjendjes civile dhe për rrjedhojë kemi të bëjmë me një identitet të rremë. Në këtë kontekst, është thelbësore të theksohet se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një kallëzim anonim në kuptimin klasik të ligjit, por me një dokument të paraqitur në formën e një kallëzimi të identifikuar, përmes përdorimit të një identiteti të rremë konkret, të shoqëruar me nënshkrim fizik. Ky element e diferencon rrënjësisht këtë rast nga një komunikim anonim, pasi kemi një simulim të vetë identitetit të kallëzuesit, me qëllim krijimin e një besueshmërie të rreme përpara organit procedues.

2. Nga aktet e administruara rezulton se dokumenti “Të dhëna për SPAK” është shkruar me kompjuter, është protokolluar me nr. K.536 Prot., datë 19.07.2023 dhe mban vulën përkatëse të Prokurorisë së Posaçme. Në fund të dokumentit, poshtë emrit “Nesti Angoni”, është vendosur një nënshkrim me shkrim dore. Ky fakt tregon qartë se personi që ka hartuar dokumentin nuk është kufizuar në paraqitjen e informacionit në mënyrë anonime, por ka zgjedhur të krijojë një identitet të rremë dhe ta materializojë atë përmes një nënshkrimi fizik, duke e paraqitur dokumentin si të ardhur nga një subjekt konkret dhe i identifikueshëm. Ky veprim përbën një paraqitje të rreme të rrethanave faktike përpara një organi publik, me qëllim ndikimin në vendimmarrjen e tij.

3. Nënshkrimi i vendosur në dokument nuk i përket një personi real, por është përdorur për të materializuar një identitet të rremë, duke krijuar një paraqitje të pavërtetë përpara organit publik. Nëse autori do të kishte dashur të mbetej anonim, ai do të paraqitej si i tillë. Zgjedhja për të përdorur një emër konkret dhe për ta shoqëruar atë me nënshkrim fizik nuk është rastësore, por synon të krijojë një perceptim të rremë identiteti dhe besueshmërie, duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerësimin e organit procedues për seriozitetin e informacionit të paraqitur.

4. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke marrë shkas nga ky dokument, ka regjistruar në datën 08.02.2024 procedimin penal nr. 27/2024 për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, pa autor. Në muajin korrik 2023 pranë kësaj prokurorie është protokolluar një kallëzim penal i hartuar nga një shtetas i vetëquajtur “Nesti Angoni”, për të cilin nuk ekziston asnjë e dhënë në regjistrat zyrtarë të gjendjes civile. Përmbajtja e këtij dokumenti përfshin pretendime të përgjithshme dhe të pa verifikuara mbi marrëdhënie të supozuara dhe përfitime të mundshme, pa asnjë mbështetje në prova konkrete.

5. Në këtë mënyrë, dokumenti “Të dhëna për SPAK” përmban elementë të paraqitjes së rreme të identitetit dhe rrethanave, të përdorura në mënyrë të qëllimshme për të krijuar një bazë artificiale për iniciimin e një procedimi penal. Personi që ka hartuar dhe nënshkruar këtë dokument ka paraqitur rrethana të pavërteta, duke firmosur në emër të një personi që nuk ekziston.

6. Ky veprim nuk ka mbetur në nivelin e një komunikimi të thjeshtë, por ka prodhuar pasoja konkrete juridike, pasi mbi bazën e këtij dokumenti është regjistruar procedimi penal nr. 27/2024 dhe janë ndërmarrë veprime hetimore, duke cenuar drejtpërdrejt të drejtat dhe interesat

e kallëzuesit. Ky rast nuk përbën një thjesht pasaktësi dokumentare, por një ndërhyrje aktive në mekanizmin e nisjes së ndjekjes penale, duke përdorur një identitet të rremë për të krijuar një bazë të pavërtetë mbi të cilën është ndërtuar një procedim penal.

## **LIGJI I APLIKUESHËM DHE ANALIZA JURIDIKE**

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280 dhe 283, përcakton mënyrën e marrjes dijeni për veprën penale dhe detyrimin për kallëzim. Ndërkohë, neni 186 i Kodit Penal parashikon se falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet sipas ligjit.

### **Objekti i veprës penale**

7. Objekt i veprës penale, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal nuk kufizohet vetëm në mbrojtjen formale të dokumenteve si mjete materiale, por shtrihet në mënyrë thelbësore mbi mbrojtjen e besimit publik dhe të funksionimit të rregullt të institucioneve shtetërore, të cilat mbështeten në vërtetësinë dhe autenticitetin e dokumentacionit që administrojnë. Në veçanti, kjo dispozitë synon të garantojë që çdo dokument i paraqitur përpara një organi publik të pasqyrojë në mënyrë të saktë dhe të vërtetë rrethanat faktike dhe identitetin e personit që e ka hartuar apo nënshkruar atë, pasi mbi këtë bazë ndërtohet vendimmarrja e administratës dhe, në rastin konkret, e organit të ndjekjes penale.

8. Integriteti i dokumenteve është një parakusht i domosdoshëm për funksionimin normal të drejtësisë penale, pasi prokuroria, në ushtrimin e funksioneve të saj kushtetuese dhe ligjore, mbështetet në informacionin e paraqitur për të vlerësuar ekzistencën e indiceve për kryerjen e një veprë penale dhe për të vendosur nëse duhet të regjistrojë një procedim penal. Në këtë kuptim, çdo ndërhyrje në vërtetësinë e dokumenteve, veçanërisht përmes paraqitjes së një identiteti të rremë të shoqëruar me nënshkrim, cenon jo vetëm korrektësinë formale të dokumentit, por edhe vetë mekanizmin e funksionimit të drejtësisë penale, duke krijuar një bazë të pavërtetë mbi të cilën mund të ndërtohen veprime procedurale me pasoja të rënda.

9. Në rastin konkret, paraqitja e një dokumenti të nënshkruar në emër të një personi që nuk ekziston nuk përbën thjesht një pasaktësi formale, por një cenim të drejtpërdrejtë të këtij objekti juridik, pasi krijon një perceptim të rremë përpara organit procedues se informacioni vjen nga një burim real dhe i identifikueshëm. Kjo sjell si pasojë deformimin e procesit të vlerësimit të informacionit nga prokuroria dhe cenon besimin që shteti duhet të ketë në dokumentacionin që

i paraqitet, duke rrezikuar që mekanizmat e ndjekjes penale të vihen në lëvizje mbi baza të pavërteta. Për rrjedhojë, veprime të tilla prekin drejtpërdrejt objektin e mbrojtur nga neni 186 i Kodit Penal, pasi cenojnë sigurinë juridike dhe funksionimin e rregullt të institucioneve shtetërore, në veçanti të organit të ndjekjes penale.

### **Ana objektive**

**10.** Ana objektive e veprës konsiston në krijimin, ndryshimin ose përdorimin e një dokumenti që përmban të dhëna të pavërteta, me qëllim që ky dokument të paraqitet si i vërtetë përpara organeve publike apo subjekteve të tjera. Këto veprime materializohen në ndërhyrje konkrete mbi përmbajtjen ose formën e dokumentit, duke përfshirë edhe rastet kur në një dokument paraqitet në mënyrë të pavërtetë identiteti i autorit të tij, përmes përdorimit të një emri të rremë apo të një nënshkrimi që nuk i përket një personi real.

**11.** Në këtë kuptim, falsifikimi nuk kufizohet vetëm në ndryshimin e përmbajtjes së dokumentit, por përfshin edhe krijimin e një dokumenti që në tërësinë e tij paraqet një realitet të pavërtetë, duke simuluar ekzistencën e një subjekti juridikisht të identifikueshëm që në fakt nuk ekziston. Në rastin konkret, elementi objektiv i veprës penale konsiston në hartimin dhe paraqitjen e dokumentit “Të dhëna për SPAK”, në të cilin është përdorur një identitet i rremë (“Nesti Angoni”), i materializuar përmes një nënshkrimi fizik, duke krijuar kështu një dokument që paraqitet si i ardhur nga një person real dhe i identifikueshëm.

**12.** Ky dokument është depozituar dhe administruar në një institucion publik dhe ka shërbyer si bazë për iniciimin e një procedimi penal, çka dëshmon se veprimi nuk ka mbetur në nivelin e një përgatitjeje formale, por është përdorur realisht për të prodhuar pasoja juridike. Për rrjedhojë, përmes këtyre veprimeve është krijuar dhe përdorur një dokument që paraqet në mënyrë të pavërtetë identitetin e autorit të tij, duke plotësuar elementin objektiv të veprës penale.

### **Subjekti**

**13.** Subjekt i veprës penale të falsifikimit mund të jetë çdo person fizik që ka arritur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm, pavarësisht nëse ushtron apo jo një funksion publik, si dhe çdo subjekt juridik në rastet kur veprimi kryhet në kuadër të veprimtarisë së tij. Në rastin konkret, fakti që identiteti i përdorur në dokument (“Nesti Angoni”) nuk i përket një

personi real nuk përjashton ekzistencën e subjektit të veprës penale, por përkundrazi tregon se kemi të bëjmë me një autor real të pidentifikuar, i cili ka vepruar duke përdorur një identitet të rremë për të fshehur personalitetin e tij.

**14.** Pra, mungesa e një personi real me këtë emër nuk e përjashton përgjegjësinë penale, por është pikërisht një tregues i mënyrës së kryerjes së veprës, nëpërmjet simulimit të identitetit, me qëllim shmangien e identifikimit dhe rritjen e besueshmërisë së dokumentit të paraqitur. Në këtë kuptim, subjekti i veprës penale nuk është personi fiktiv i përdorur në dokument, por personi real që ka hartuar dhe nënshkruar këtë dokument në emër të një identiteti të rremë, i cili mbetet për t'u identifikuar nëpërmjet hetimit penal. Për rrjedhojë, elementi i subjektit të veprës penale rezulton i plotësuar, pasi ekziston një autor real, edhe pse aktualisht i pidentifikuar, i cili ka kryer veprimet materiale të përshkruara më sipër.

### **Ana subjektive**

**15.** Nga ana subjektive, vepra penale e falsifikimit kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, pasi autori është i ndërgjegjshëm për pavërtetësinë e të dhënave që paraqet dhe synon që dokumenti i krijuar të perceptohet si i vërtetë nga organet publike apo subjektet përkatëse. Në rastin konkret, dashja direkte rezulton nga vetë mënyra e kryerjes së veprimit. Personi që ka hartuar dokumentin “Të dhëna për SPAK” nuk ka vepruar në mënyrë spontane apo të paqëllimshme, por ka ndërmarrë një veprim të strukturuar, duke përzgjedhur të përdorë një identitet të rremë konkret dhe duke e materializuar atë përmes një nënshkrimi fizik.

**16.** Përdorimi i një emri të caktuar (“Nesti Angoni”), i shoqëruar me firmë, tregon qartë se autori ka qenë plotësisht i ndërgjegjshëm se nuk po paraqitej si person anonim, por po krijonte një perceptim të rremë të një kallëzuesi real dhe të identifikueshëm. Kjo zgjedhje nuk është rastësore, por e qëllimshme, pasi synon të rrisë besueshmërinë e dokumentit dhe të ndikojë në vlerësimin e organit procedues për seriozitetin e informacionit të paraqitur.

**17.** Për më tepër, fakti që dokumenti është përdorur për të vënë në lëvizje organin e ndjekjes penale dhe për të inicuar një procedim penal tregon se veprimi është kryer me qëllim konkret për të prodhuar pasoja juridike, duke përmbushur kështu elementin e qëllimit në kuptimin penal. Në këto kushte, autori ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, duke qenë plotësisht i vetëdijshëm për karakterin e rremë të identitetit të përdorur dhe për efektin që ky dokument do të prodhonte, çka përmbush elementin subjektiv të veprës penale.

18. Nëse autori do të kishte qëllim vetëm të informonte organin procedues, ai do të kishte zgjedhur të mbetej anonim; përdorimi i një identiteti të rremë të shoqëruar me nënshkrim tregon qartë synimin për të krijuar një realitet të pavërtetë dhe për të ndikuar në mënyrë aktive në procesin penal.

## **MUNGESA E GJURMUESHMËRISË DHE NEVOJA PËR VERIFIKIM**

19. Nga analiza e akteve të administruara në dosje rezulton se nuk ekziston asnjë e dhënë e qartë dhe e verifikueshme lidhur me mënyrën konkrete të administrimit të dokumentit “Të dhëna për SPAK”. Kjo mungesë nuk përbën një mangësi të thjeshtë formale, por krijon pasiguri serioze mbi origjinën dhe autenticitetin e dokumentit dhe kërkon verifikim të plotë të mënyrës së depozitimit dhe trajtimit të tij. Në një procedim penal ku çdo veprim duhet të jetë i dokumentuar dhe i gjurmueshëm, mungesa e këtyre të dhënave përbën një devijim serioz nga standardet e një procesi të rregullt ligjor.

20. Në këto kushte, është e domosdoshme të verifikohet:

- a) mënyra e depozitimit të dokumentit
- b) personat që e kanë administruar dhe regjistruar atë
- c) procedurat e ndjekura për trajtimin e tij

Kjo për të garantuar integritetin dhe gjurmueshmërinë e procesit penal.

## **MUNGESA E NJË KALLËZIMI PENAL DHE STANDARDI I *NOTITIA CRIMINIS***

21. Në sistemin procedural penal shqiptar, regjistrimi i një kallëzimi në regjistrin e veprave penale nuk përbën një reagim mekanik ndaj çdo akti të paraqitur si “kallëzim”, por një vendimmarrje juridike të kushtëzuar nga ekzistenca reale dhe e verifikueshme e një njoftimi për veprën penale (*notitia criminis*). Ky standard është saktësuar në mënyrë të qartë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2024-1222, datë 12.03.2024, i cili vendos kufij të prerë ndaj diskrecionit të prokurorit në këtë fazë fillestare të procedimit.

22. Thelbi i këtij standardi qëndron në dallimin konceptual dhe funksional ndërmjet informacionit të thjeshtë dhe njoftimit juridikisht relevant për një veprë penale. Jo çdo informacion, edhe kur paraqitet në formën e një kallëzimi, është i aftë të aktivizojë regjistrimin e tij në regjistrin e veprave penale. Për të marrë këtë cilësi, ai duhet të përmbajë elementet

thelbësore të faktit penal, të identifikueshme në komponentët e anës objektive të figurës së veprës penale: një sjellje konkrete (veprim apo mosveprim), një pasojë juridikisht të rëndësishme dhe një lidhje shkakësore ndërmjet tyre. Në mungesë të këtyre elementëve, nuk kemi më një “njoftim për vepër penale”, por një konstruksion hipotetik ose thashetheme, si në rastin konkret, të cilat nuk mund të prodhojnë pasoja procedurale penale, siç është regjistrimi i një kallëzimi penal.

23. Gjykata e Lartë e ka artikuluar këtë standard përmes dy kritereve kumulative: hipoteticitetit të strukturuar dhe specificitetit indicjar. Sipas Gjykatës së Lartë, hipoteticiteti nuk nënkupton një hamendje të lirë, por ekzistencën e një hipoteze krimi të ndërtuar mbi një fakt të identifikueshëm dhe mbi një subjekt potencialisht përgjegjës. Specificiteti, nga ana tjetër, kërkon që ky fakt të jetë i konkretizuar në kohë, hapësirë dhe rrethana, në mënyrë që të dallojë qartë nga dyshimet e përgjithshme apo nga pretendimet abstrakte. Vetëm në prani të këtyre elementëve mund të thuhet se ekziston një minimum indicjar që justifikon regjistrimin e një kallëzimi penal. Pra përveçse do të duhet të ketë fakte të përshkruara, këto fakte duhet të kenë elementë specifike të karakterit indicjar, duke pasur kështu një standard provues. Sipas GJL, konsiderohen të pamjaftueshme për t'u konsideruar “kallëzim”, aktet në të cilat vetëm hidhen dyshime të thjeshta.

24. Në këtë kuadër, Gjykata e Lartë ka përjashtuar në mënyrë eksplicite nga fusha e “kallëzimit” të vlefshëm çdo akt që përmban pretendime të përgjithshme, të painedividualizuara, apo akuza “në bllok”, të pambështetura në një substrat faktik konkret. Këto forma të komunikimit nuk përbëjnë *notitia criminis*, pasi nuk japin asnjë mundësi reale për identifikimin e një fakti penal të caktuar, por thjesht transferojnë tek organi i akuzës detyrën për të “kërkuar” në mënyrë eksplorative nëse ekziston apo jo një shkelje penale. Një qasje e tillë bie në kundërshtim me vetë logjikën e procedimit penal, i cili nuk mund të vihet në lëvizje mbi bazën e supozimeve, por vetëm mbi bazën e një informacioni të strukturuar dhe juridikisht të verifikueshëm. Nga kjo rrjedh një pasojë e drejtpërdrejtë procedurale: në mungesë të *notitia criminis*, prokurori nuk ka vetëm diskrecion, por detyrim për të mos regjistruar kallëzimin penal. Në rast se, përkundër këtij standardi, është kryer një regjistrim, atëherë organi i akuzës ka detyrimin të disponojë mosfillimin e procedimit, pasi mungon vetë premisa ligjore që legjitimon ekzistencën e tij. Çdo veprim ndryshe do të përbënte një devijim nga kërkesat e ligjit procedural dhe një zgjerim të paligjshëm të funksionit hetimor.

25. Ky standard ka edhe një funksion mbrojtës sistemik: ai parandalon transformimin e prokurorisë nga një organ që reagon ndaj një fakti penal të njoftuar, në një organ që vihet në lëvizje mbi bazën e hipotezave, thashethemeve apo manipulimeve faktike. Pranimi i kundërt do të krijonte mundësinë që çdo subjekt, përmes paraqitjes së një dokumenti formal të quajtur “kallëzim”, të aktivizonte ndjekjen penale pa mbajtur asnjë barrë minimale për konkretizimin e faktit penal, duke e kthyer procesin penal në një instrument të ekspozuar ndaj abuzimit.

26. Në këtë prizëm, kërkesa për ekzistencën e një *notitia criminis* të mirëfilltë është një kusht themelor legjitimiteti për vetë fillimin e procedimit penal. Kur ky kusht mungon, si në rastin konkret, qoftë për shkak të mungesës së fakteve konkrete, qoftë për shkak të natyrës së pavërtetë apo të manipuluar të informacionit, çdo procedim i regjistruar mbi këtë bazë rezulton i paaftë për të prodhuar pasoja juridike të vlefshme.

27. Për më tepër, në rastin konkret mungon edhe vetë premisa formale e ekzistencës së një kallëzimi në kuptimin procedural të ligjit, pasi dokumenti mbi të cilin është vënë në lëvizje mekanizmi penal nuk është paraqitur si kallëzim penal, por si një shkresë e titulluar “Të dhëna për SPAK”. Ky element ka rëndësi në planin juridik, sepse tregon se organi procedues nuk është vënë përpara një akti që, qoftë edhe formalisht, synon të marrë cilësinë e kallëzimit sipas neneve 280 dhe 283 të K.Pr.Penale. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë as me një kallëzim të rregullt që më pas rezulton i pamjaftueshëm në përmbajtje, por me një informacion të paraqitur jashtë formës tipike të kallëzimit, i cili, për të prodhuar pasojën e regjistrimit të procedimit penal, duhej të kalonte edhe më fort në filtrin e verifikimit paraprak të ekzistencës së një *notitia criminis* të mirëfilltë. Pikërisht për këtë arsye, regjistrimi i procedimit penal mbi bazën e një akti të tillë nuk mbështetet as mbi një kallëzim në kuptimin formal të ligjit, por mbi një material informues, i cili, nga vetë natyra e tij nuk mund të regjistrohej.

28. Më tej, këtë përfundim e përforcon edhe vetë qëndrimi publik dhe zyrtar i SPAK-ut, i publikuar në faqen e tij zyrtare,<sup>1</sup> sipas të cilit, bazuar në nenet 281–284 të Kodit të Procedurës Penale, “kallëzime penale do të konsiderohen vetëm ato që depozitohen në Prokurorinë e Posaçme në formë të shkruar dhe që plotësojnë elementët formale dhe procedurale”. Kjo do të thotë se edhe sipas standardit që vetë Prokuroria e Posaçme i ka komunikuar publikut, jo çdo material informues, jo çdo shkresë dhe jo çdo pretendim i depozituar pranë saj prodhon automatikisht pasojën procedurale të trajtimit si kallëzim penal. Përkundrazi, ekziston një filtër

---

<sup>1</sup> <https://spak.gov.al/denonco-2/>

paraprak formal dhe procedural, pa përmbushjen e të cilit akti nuk hyn në kategorinë e kallëzimit penal në kuptimin juridik.

**29.** Pra, në rastin konkret nuk jemi përpara një kallëzimi penal të rregullt, i cili thjesht mund të diskutohej nëse ishte i mjaftueshëm ose jo në përmbajtje, por përpara një materiali të titulluar “Të dhëna për SPAK”, i cili, nga vetë forma e tij, nuk është paraqitur si kallëzim penal dhe, për më tepër, nuk rezulton të përmbushë as standardin formal e procedural që vetë SPAK ka deklaruar publikisht si kusht për ta konsideruar një akt të tillë “kallëzim”. Në këto kushte, përdorimi i këtij materiali si bazë për regjistrimin e procedimit penal nuk bie vetëm ndesh **(1)** me Kodin e Procedurës Penale, **(2)** të interpretuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për ekzistencën e një *notitia criminis* të mirëfilltë, por edhe **(3)** me vetë kriteret e shpallura nga institucioni që e ka administruar atë.

**30.** Madje, ky fakt e bën shkeljen edhe më të dukshme, duke ngritur një pyetje të natyrshme: përse vetëm në rastin e Erion Veliajt është devijuar nga standardi që vetë SPAK ka deklaruar publikisht se zbaton? Duke qenë se vetë SPAK pranon se vetëm aktet që përmbushin elementët formalë dhe proceduralë mund të konsiderohen kallëzime penale, rezulton se një dokument që nuk është paraqitur si kallëzim, që ka formën e një informacioni dhe që lidhet me një identitet të rremë, është ngritur në mënyrë artificiale në rangun e një kallëzimi penal të vlefshëm. Kjo bie në kundërshtim jo vetëm me legjislacionin procedural penal dhe me interpretimin e dhënë nga Gjykata e Lartë, por edhe me standardin që vetë organi procedues ka shpallur publikisht për mënyrën e trajtimit të denoncimeve dhe kallëzimeve që paraqiten përpara tij. Për më tepër, një qasje e tillë krijon dyshime të arsyeshme mbi arsyet pse një devijim i tillë është pranuar pikërisht në këtë rast, që lidhet njëkohësisht me një kallëzues inekzistent dhe me një figurë të spikatur politike dhe institucionale.

## KONKLUZION

**31.** Në asnjë rast nuk mund të konsiderohet e pranueshme që një procedim penal të vihet në lëvizje mbi bazën e veprimeve që në vetvete paraqesin elementë të një vepre penale. Pranimi i një logjike të tillë do të çonte në legjitimimin e përdorimit të mjeteve të kundërligjshme për të inicuar ndjekje penale, duke deformuar rëndë funksionin e drejtësisë dhe duke cenuar parimet themelore të shtetit të së drejtës.

**32.** Një qasje e tillë do të krijonte rrezikun real që mekanizmi penal të përdoret në mënyrë selektive, mbi baza të fabrikuara, thjesht për të justifikuar nisjen e hetimeve ndaj individëve të caktuar. Për rrjedhojë, është thelbësore që çdo procedim penal të mbështetet mbi burime të ligjshme dhe të verifikueshme, dhe jo mbi veprime që, në vetvete, cenojnë ligjin penal. Ndryshe, do të legjitimohej një praktikë e papranueshme, ku vetë shkelja e ligjit penal do të përdorej si mjet për vënien në lëvizje të ndjekjes penale, duke përmbysur logjikën themelore të sistemit të drejtësisë.

**33.** Një qasje e tillë do të krijonte rrezikun real që subjektet e ngarkuara me zbatimin e ligjit, në vend që ta garantojnë atë, të përfshihen në shkeljen e tij në mënyrë selektive, me qëllim realizimin e objektivave të paracaktuara, duke cenuar rëndë parimet e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike.

**34.** Për sa më sipër, kërkoj:

- i. regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal si dhe cdo vepër tjetër relevante që del gjatë hetimit.
- ii. identifikimin e autorit real që ka hartuar dhe nënshkruar dokumentin “Të dhëna për SPAK”

Bashkëlidhur kallëzimit vihet në dispozicion dokumenti “Të dhëna për SPAK”.

**KALLËZUESI**

**Erion VELIAJ**